



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-020/01-142527/26 me 16 SEP 2026

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës “ nr.28/24, qershor 2028), nenit 5, paragrafi 5.2 të Ligjit për ndërmarrjet publike nr.03/L-087, të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01.nr. 110-391, të dt.25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

PËR LIRIMIN NGA DETYRA E ANËTARIT NË KOMISIONIN KOMUNAL TË AKSIONARËVE PËR NDËRMARRJEN PUBLIKE KOMUNALE “ SPORT MARKETING” SH.A.

1. Z. Faton Pacolli, i emëruar sipas Vendimit nr.14-020/01-94775/26, i datës 29.06.2026, lirohet nga detyra e anëtarit në komisionin komunal të aksionareve për ndërmarrjen publike lokale të Kryeqytetit “ Sport Marketing “SH.A.
2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- Z. Faton Pacolli;
- Qendrës për Shërbim me Qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

